



## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

### KËRKESË

#### PARTIA E PROSPERITETIT DEMOKRATIK TË SHQIPËRISË

z.Yzeir FETAHU

Me vendimin nr. 112 datë 27.03.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatin e shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar (auditët ligjorë), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfuara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin 2018.

Me këtë vendim, KQZ-ja më ka emëruar, me cilësinë e auditit ligjor, të auditoj fondet e përfuara dhe të shpenzuara nga ju, si parti politike, për vitin 2018.

Me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është lidhur kontrata me nr.prot të tyre 1331/1, datë 17/05/2019 me objekt: Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfuara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018, për partitë politike në përputhje me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, dhe me ligjin nr.9228, dt.29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre.

Në pamundësi të lidhjes direkte me ju, kërkoj të më krijoni mundësinë e kontaktit (të shkruara në fund të kësaj faqeje), në mënyrë që të realizoj misionin tim sipas kontratës së sipërcituar. Ju lutem, përcaktoni datën dhe vendin e takimit, ku të marrë pjesë dhe personi i ngarkuar nga ju për problemet financiare të partise suaj.

Sipas vendimit nr.266 datë 01.06.2009 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ju duhet të paraqitni përpara audituesit ligjor (ekspertit kontabël), regjistrin e fondeve të përfuara dhe të shpenzuara gjatë vitit 2018.

Për të mundësuar ekzekutimin e detyrave të ngarkuara nga kontrata me nr.prot të tyre 1331/1, datë 17/05/2019 me objekt: Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfuara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018, për partitë politike në përputhje me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, dhe me ligjin nr.9228, dt.29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre, Ju lutemi të vini në dispozicion të Auditueses të gjitha dokumentet financiare të nevojshme:

- Pasqyrat financiare vjetore me të gjithë dokumentacionin shoqëruar me firmë dhe vulë origjinale.
- Deklaratën vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve mbi fondet e përfuara dhe të shpenzuara nga partia politike për periudhën financiare 01.01.2018-31.12.2018.
- Llogaritë bankare me të cilat keni pasë veprimtari financiare, të skanuara, nga 01 janar 2018 deri 31/12/2018.

Rr. "Millo Tutulani", godina 6, hyrja 9, kodi postar 1019, Njësia administrative 5, Tiranë  
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;  
e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail: [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)



## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- Dokumentacionin financiar (dhe shkresën përkatëse) në rast se keni pasë nga KQZ për kalimin e fondeve nga Ministria e Financave për llogari të partisë "Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë" gjatë vitit financiar 2018 pra, justifikimin shkresor të çdo hyrjeje në llogarinë bankare tuajën nga Ministria e Financave për vitin 2018. Në rast kthimi të fondeve të marra paraprakisht nga "Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë", për llogari të KQZ-së, justifikimin shkresor dhe urdhër xhirimin për kthimin e shumës.
- Dokumentacionin financiar: mandat arketimet dhe listën e personave që kanë kontribuar me fonde për llogari të partisë "Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë" gjatë vitit financiar 2018, pra justifikimin shkresor të çdo hyrjeje në llogarinë bankare ose arkën e partisë "Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë".
- Borderotë janar - dhjetor 2018 dhe pagesat e kontributeve sipas periudhave.
- Dokumentacionin financiar të shpenzimeve për vitin financiar 2018, fatura blerjeje, pagesa, kuponë tatimorë dhe çdo dokument mbi bazën e të cilave subjekti ka hartuar pasqyrat financiare.
- Raportet e auditimit vjetor të vitit financiar 2017 e, nëse ka, dhe letrën për drejtimin ose rekomandime për të së bashku me auditimin.

Së bashku me dokumentacionin financiar, Ne duhet të hartojmë, të plotësojmë dhe të firmosim një pyetësor mbi:

- Emrin e Partisë me ndryshimet ligjore gjatë vitit financiar 2018 ose edhe me përpara në rast se këto ndryshime nuk janë evidentuar në KQZ dhe në institucionet shtetërore.
- Planifikimin e kohës kur mund të fillojmë dhe mbarojmë auditimin.
- Ku mund të bëhet kontrolli i dokumentacionit.
- Personi përfaqësues i Partisë që do të vërë në dispozicion të ekspertit evidencën e auditimit.
- Kur mund të fillojmë auditimin në vartësi të evidencës së siguruar nga Ju për auditimin.
- Kur merret evidenca e auditimit, pra data e marrjes së evidencës.
- Personat përgjegjës për kontabilitetin, donacionet, arkën.
- Sa llogari bankare ka partia politike.
- Burimet e financimit me vlera dhe përqindje në krahasim me totalin e të ardhurave të deklaruara.
- A ka pasë të ardhura monetare në cash ( mjete monetare në dorë) dhe mënyra si janë regjistruar këto hyrje monetare.
- A është plotësuar deklarata e konfliktit të interesit në rastet e dhurimeve.
- A është zbatuar ligji mbi mënyrën e përfitimit të donacioneve.
- A ka donacione që kanë kaluar kufirin dhe donacionet kumulative.
- A janë depozituar të gjitha donacionet në llogari bankare specifike.
- A ka donacione në natyrë , çfarë dhe si janë dokumentuar.
- A i ka pasqyruar Partia politike të gjithë informacionet që kërkon ligji :

Rr. "Millo Tutulani", godina 6, hyrja 9, kodi postar 1019, Njësia administrative 5, Tiranë  
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;  
e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail: [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)



## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- o Deklaratën e konfliktit të interesit,
- o Raportet e auditimit,
- o Listën e dhurimeve.

Ju lutem bëni te mundur përcaktimin e një orari dhe afati kohor për paraqitjen e Auditueses në selinë e Partisë në zbatim të nenit 5 pika 5.2 përcaktuar në kontratën e shërbimit lidhur me datë 17.05.2019 me nr. prot 1331/1, mes Audituese Ligjore, znj. Fatmira Kastrati (Sykja) dhe KQZ-së.

Në përfundim të auditimit, ne, së bashku me raportin e auditimit ku do shprehim opinionin, parashikojmë t'u lëmë edhe një letër për drejtimin ku mund të shprehemi për rekomandimet dhe sugjerimet tona për përmirësimin e punës në të ardhmen nëse është e nevojshme.

Duke ju falenderuar,



Tiranë, më 30 maj 2019

Adresa: Fsh. 100, Tiranë (Tirana)


Adresa: "Mullatë" Tiranë

M. 6, Nr. 9, Kështjorët 1019

Shërbimi Administrativ 5

TIRANË

56



Mene

Kadry e Pasqyve të Demokracisë të  
Shqiptare

Z. Zeynep Bekar

TIRANË

